


# Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistike në Shqipëri, 2019

**Tiranë, 22 Qershor, 2021:** Në vitin 2019, sipas rajoneve statistikore në nivel 1 (Republika e Shqipërisë), PBB me çmime korente u vlerësua 1.691.729 milionë Lekë, duke shënuar një rritje në terma realë prej rreth 2,11 %, krahasuar me vitin 2018.

Kontributin më të madh në rritjen ekonomike për vitin 2019, e ka dhënë Qarku Tiranë me +1,06 pikë përqindje, pasuar nga Qarku Durrës me +0,43 pikë përqindje dhe Qarku Fier me +0,36 pikë përqindje. Kontributin më të ulët në rritjen ekonomike e ka dhënë Qarku Dibër me -0,09 pikë përqindje, i pasuar nga Qarku Berat me një kontribut prej -0,07 pikë përqindje dhe Qarku Kukës me një kontribut prej -0,05 pikë përqindje.

Fig.1 Kontributi i Qarqeve në rritjen ekonomike



\*2019 Të dhëna gjysmë-finale

Për publikim 22/06/2021

Në vitin 2019, sipas rajoneve statistikore në nivel 2, PBB me çmime korente në rajonin Veri ishte 389,6 miliardë Lekë ose 23,03 % ndaj totalit të vendit. Krahasuar me vitin 2018, në rajonin Veri, PBB në terma reale shënoi një rritje me 2,16 %.

PBB me çmime korente në rajonin Qendër, ishte 835,1 miliardë Lekë ose 49,36 % ndaj totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2018, për rajonin Qendër, PBB në terma reale shënoi një rritje prej 2,28 %.

PBB me çmime korente në rajonin Jug ishte 467,1 miliardë Lekë ose 27,61 % ndaj totalit të vendit. Krahasuar me vitin 2018, në rajonin Jug, PBB në terma reale shënoi një rritje me 1,78 %.

Sipas rajoneve statistikore në nivel 3 (Qark), rritjen reale më të lartë e shënoi Qarku Durrës me një rritje në terma realë prej 4,37 %, i ndjekur nga Qarku Gjirokastër me një rritje reale prej 3,99 % dhe Qarku Fier me një rritje në terma realë prej 3,26 % të PBB-së për vitin 2019, krahasuar me vitin 2018.

Rritja ekonomike u ngadalësua në Dibër, duke shënuar një rënie në terma realë prej 2,89 %, më tej renditet Qarku Kukës me një rënie në terma reale prej 2,80 % dhe Qarku Berat me një rënie reale prej 2,06 % të PBB-së për vitin 2019, krahasuar me vitin 2018.

**Tab. 1 PBB sipas rajoneve statistikore**


Kodi	Niveli Statistikor 2 / 3	PBB çmime korente (milion Lekë)	PBB çmime korente (milion Lekë)	Rritja Reale e PBB-së	Kontributi ndaj rritjes Reale	Struktura ndaj PBB- së	Struktura ndaj PBB-së
		2018	2019*	2019*/2018	2019*/2018	2018	2019*
<b>AL</b>	<b>Republika e Shqipërisë</b>	<b>1.636.731</b>	<b>1.691.729</b>	<b>2,11</b>	<b>2,11</b>	<b>100,00</b>	<b>100,00</b>
AL01	Veri	<b>377.010</b>	<b>389.567</b>	<b>2,16</b>	<b>0,50</b>	<b>23,03</b>	<b>23,03</b>
AL011	Dibër	52.106	50.964	-2,89	-0,09	3,18	3,01
AL012	Durrës	162.378	172.276	4,37	0,43	9,92	10,18
AL013	Kukës	27.936	27.322	-2,80	-0,05	1,71	1,62
AL014	Lezhë	50.972	52.948	2,63	0,08	3,11	3,13
AL015	Shkodër	83.618	86.057	2,39	0,12	5,11	5,09
AL02	Qendër	<b>807.331</b>	<b>835.116</b>	<b>2,28</b>	<b>1,12</b>	<b>49,33</b>	<b>49,36</b>
AL021	Elbasan	110.379	112.383	0,87	0,06	6,74	6,64
AL022	Tiranë	696.952	722.733	2,50	1,06	42,58	42,72
AL03	Jug	<b>452.391</b>	<b>467.046</b>	<b>1,78</b>	<b>0,49</b>	<b>27,64</b>	<b>27,61</b>
AL031	Berat	58.547	58.119	-2,06	-0,07	3,58	3,44
AL032	Fier	178.368	187.306	3,26	0,36	10,90	11,07
AL033	Gjirokastër	35.572	37.295	3,99	0,09	2,17	2,20
AL034	Korçë	87.837	91.138	2,02	0,11	5,37	5,39
AL035	Vlorë	92.067	93.188	0,27	0,02	5,63	5,51

\*2019 Të dhëna gjysmë-finale

**PBB për frymë sipas niveleve statistikore**

Në vitin 2019, niveli i PBB-së për frymë në rajonin statistikor nivel 1 (Republika e Shqipërisë), arriti në 593 mijë Lekë. Krahasuar me vitin 2018 PBB për frymë në terma nominale u rrit me 3,80 %.

**Fig.2 PBB për frymë sipas rajoneve statistikore nivel 3 viti 2019\* (000/Lekë)**



\* 2019 Të dhëna gjysmë-finale

Në vitin 2019, sipas rajoneve statistikore në nivel 2, në rajonin statistikor Veri, PBB për frymë është 481 mijë Lekë, duke shënuar një rritje nominale me 4,29 %, krahasuar me vitin 2018. PBB për frymë e këtij rajoni është 18,78 % nën mesataren e vendit.

Në rajonin statistikor Qendër, PBB për frymë është 712 mijë Lekë dhe pati një rritje nominale me 2,84 %, krahasuar me vitin 2018. PBB për frymë e këtij rajoni rezultoi 20,10 % mbi mesataren e vendit.

Në rajonin statistikor Jug, PBB për frymë është 536 mijë Lekë, duke shënuar një rritje nominale me 4,60 %, krahasuar me vitin 2018. PBB për frymë e këtij rajoni është 9,61 % nën mesataren e vendit.

Niveli më i lartë i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore në nivel 3 (Qark), në vitin 2019, ishte në Qarkun Tiranë, me 802 mijë Lekë dhe shënoi një rritje në terma nominale prej 2,42 %, krahasuar me vitin 2018. PBB për frymë e këtij qarku ishte 35,38 % mbi mesataren e vendit. Më pas renditet Qarku Fier, me 641 mijë Lekë, duke shënuar një rritje në terma nominale prej 6,49 % ndaj vitit 2019. PBB për frymë e këtij qarku ishte 8,11 % mbi mesataren e vendit.

Niveli më i ulët i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore në nivel 3 (Qark) në vitin 2019, u vlerësua në Qarkun Kukës me rreth 359 mijë Lekë duke shënuar një rënie në terma nominale me 0,94 %, krahasuar me vitin 2018. PBB për frymë e këtij qarku ishte 39,36 % nën mesataren e vendit. Më tej, me PBB-në për frymë më të ulët vijon Qarku Elbasan me rreth 412 mijë Lekë duke shënuar një rritje në terma nominale 3,40 % ndaj vitit 2018. PBB për frymë e këtij qarku ishte 30,43 % nën mesataren e vendit.

**Tab. 2 PBB për frymë sipas rajoneve statistikore**

Kodi	Niveli Statistikor 2/3	PBB për frymë (Lekë)	PBB për frymë (Lekë)	Rritja e PBB-së për frymë me	Indeksi ndaj	Indeksi ndaj
				çmime korente (%)	PBB-së (%) AI=100	PBB-së (%) AI=100
		2018	2019*	2019*/2018	2018	2019*
<b>AL</b>	<b>Republika e Shqipërisë</b>	<b>571.011</b>	<b>592.717</b>	<b>3,80</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>
<b>AL01</b>	<b>Veri</b>	<b>461.583</b>	<b>481.402</b>	<b>4,29</b>	<b>80,8</b>	<b>81,2</b>
AL011	Dibër	434.333	434.068	-0,06	76,1	73,2
AL012	Durrës	560.172	593.219	5,90	98,1	100,1
AL013	Kukës	362.850	359.447	-0,94	63,5	60,6
AL014	Lezhë	404.529	427.164	5,60	70,8	72,1
AL015	Shkodër	410.005	427.185	4,19	71,8	72,1
<b>AL02</b>	<b>Qendër</b>	<b>692.197</b>	<b>711.835</b>	<b>2,84</b>	<b>121,2</b>	<b>120,1</b>
AL021	Elbasan	398.818	412.375	3,40	69,8	69,6
AL022	Tiranë	783.474	802.447	2,42	137,2	135,4
<b>AL03</b>	<b>Jug</b>	<b>512.178</b>	<b>535.744</b>	<b>4,60</b>	<b>89,7</b>	<b>90,4</b>
AL031	Berat	463.561	470.301	1,45	81,2	79,3
AL032	Fier	601.683	640.762	6,49	105,4	108,1
AL033	Gjirokastrë	571.991	617.526	7,96	100,2	104,2
AL034	Korçë	420.198	441.635	5,10	73,6	74,5
AL035	Vlorë	486.367	492.758	1,31	85,2	83,1

\*2019Të dhëna gjysmë-finale

**Standardi i Fuqisë Blerëse**

PBB e Republikës së Shqipërisë e shprehur në Standardin e Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standard - PPS) në vitin 2019 është 28.076 PPS.

PBB për frymë në PPS për vitin 2019 për Republikën e Shqipërisë është 30,7 % e mesatares së Bashkimit Evropian BE28 = 100 (shih shënime metodologjike). Sipas rajoneve statistikore në nivel 2, në rajonin Qendër, PBB për frymë në PPS për vitin 2019 ishte 36,9 %, në rajonin Veri 24,9 % dhe në rajonin Jug 27,8 %.

**Tab.3 PBB për frymë në PPS (BE28=100)**

Kodi	Rajonet Statistikore	PBB për frymë në PPS (BE28=100) në 2019
	<b>Republika e Shqipërisë</b>	<b>30,7</b>
	<b>Rajone Statistikore Nivel 2</b>	
AL01	Veri	24,9
AL02	Qendër	36,9
AL03	Jug	27,8

**Tab. 4 Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe rajoneve statistikore (Dega = 100 %), viti 2019\***

Kodi	Nivelet Statistike 2/3	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria nxjerrëse; Përpunuese; Energjia; Ujë	Ndërtimi	Tregtia; Transport; Hotele	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike;	Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia etj	Arte, argëtim; çlodhje etj	VSHB me çmime bazë
<b>AL</b>	<b>Republika e Shqipërisë</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>
<b>AL01</b>	<b>Veri</b>	<b>28,3</b>	<b>29,5</b>	<b>19,8</b>	<b>21,7</b>	<b>11,5</b>	<b>24,6</b>	<b>23,9</b>	<b>13,6</b>	<b>21,5</b>	<b>14,5</b>	<b>23,0</b>
AL011	Dibër	5,8	3,7	1,1	1,2	1,2	3,0	1,8	0,4	3,3	0,8	2,9
AL012	Durrës	7,3	16,8	10,3	13,9	5,5	7,9	12,7	9,4	6,8	6,4	11,0
AL013	Kukës	2,6	1,5	0,9	0,9	1,1	2,8	1,1	0,4	2,5	0,5	1,6
AL014	Lezhë	4,7	2,5	3,6	2,6	1,3	3,7	3,4	1,3	3,3	2,3	3,1
AL015	Shkodër	7,2	5,6	3,8	4,2	2,5	4,4	5,0	2,4	5,9	3,9	5,1
<b>AL02</b>	<b>Qendër</b>	<b>20,3</b>	<b>44,1</b>	<b>59,2</b>	<b>56,4</b>	<b>75,9</b>	<b>48,1</b>	<b>52,7</b>	<b>77,5</b>	<b>54,9</b>	<b>69,8</b>	<b>49,3</b>
AL021	Elbasan	12,5	7,7	3,8	4,7	2,8	5,6	5,9	1,9	6,9	3,1	6,8
AL022	Tiranë	7,8	36,9	54,0	51,5	73,6	42,7	46,8	74,7	50,2	71,4	42,5
<b>AL03</b>	<b>Jug</b>	<b>51,3</b>	<b>26,4</b>	<b>21,0</b>	<b>21,9</b>	<b>12,6</b>	<b>27,3</b>	<b>23,4</b>	<b>8,9</b>	<b>23,6</b>	<b>15,7</b>	<b>27,6</b>
AL031	Berat	7,4	2,9	2,6	2,1	1,6	4,9	2,2	0,7	3,1	1,5	3,4
AL032	Fier	23,9	11,6	7,2	6,6	4,0	7,7	7,7	3,6	6,3	3,0	10,7
AL033	Gjirokastër	3,0	1,7	1,6	2,5	1,4	3,0	2,0	0,8	2,9	1,1	2,2
AL034	Korçë	10,2	4,2	4,4	4,4	2,2	6,1	4,5	1,2	5,5	3,3	5,4
AL035	Vlorë	7,7	4,7	6,7	5,4	2,9	8,2	6,9	3,4	3,3	2,5	5,4

\*2019 Të dhëna gjysmë-finale


Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>

**Tab. 5 Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe rajoneve statistikore (Rajoni = 100 %), viti 2019\***

Kodi	Nivelet Statistikore 2/3	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria nxjerrëse; Përpunuese; Energjia; Ujë	Ndërtimi	Tregtia; Transport; Hotele	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike;	Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia etj	Arte, argëtim; çlodhje etj	VSHB me çmime bazë
AL	<b>Republika e Shqipërisë</b>	<b>21,1</b>	<b>14,1</b>	<b>10,3</b>	<b>18,8</b>	<b>3,3</b>	<b>2,6</b>	<b>6,3</b>	<b>7,4</b>	<b>13,1</b>	<b>3,1</b>	<b>100,0</b>
AL01	<b>Veri</b>	<b>25,9</b>	<b>18,0</b>	<b>8,8</b>	<b>17,7</b>	<b>1,6</b>	<b>2,8</b>	<b>6,5</b>	<b>4,4</b>	<b>12,3</b>	<b>2,0</b>	<b>100,0</b>
AL011	Dibër	40,4	24,1	3,7	7,8	1,3	2,7	3,8	0,9	14,7	0,7	100,0
AL012	Durrës	15,1	19,2	9,9	26,2	1,8	2,1	8,0	7,1	8,9	1,7	100,0
AL013	Kukës	34,2	15,1	5,5	10,5	2,2	4,6	4,3	1,9	20,8	0,9	100,0
AL014	Lezhë	31,4	11,0	11,2	15,8	1,4	3,2	6,9	3,1	13,9	1,9	100,0
AL015	Shkodër	29,9	15,5	7,3	15,9	1,7	2,3	6,3	3,6	15,4	2,1	100,0
AL02	<b>Qendër</b>	<b>8,7</b>	<b>12,6</b>	<b>12,3</b>	<b>21,5</b>	<b>5,0</b>	<b>2,5</b>	<b>6,7</b>	<b>11,7</b>	<b>14,6</b>	<b>4,4</b>	<b>100,0</b>
AL021	Elbasan	39,5	14,7	5,5	13,7	1,4	2,2	5,7	2,2	13,9	1,2	100,0
AL022	Tiranë	3,8	11,5	12,4	23,2	5,8	2,7	7,0	13,5	15,7	4,4	100,0
AL03	<b>Jug</b>	<b>39,1</b>	<b>13,4</b>	<b>7,8</b>	<b>14,9</b>	<b>1,5</b>	<b>2,6</b>	<b>5,3</b>	<b>2,4</b>	<b>11,2</b>	<b>1,8</b>	<b>100,0</b>
AL031	Berat	45,2	11,7	7,3	11,5	1,6	3,8	4,1	1,6	12,1	1,1	100,0
AL032	Fier	45,5	18,3	6,4	11,4	1,2	1,9	4,5	2,5	7,6	0,7	100,0
AL033	Gjirokastrë	28,3	9,4	7,0	21,8	2,1	3,7	5,9	2,7	17,6	1,3	100,0
AL034	Korçë	39,8	9,7	8,0	15,8	1,4	3,0	5,4	1,7	13,7	1,6	100,0
AL035	Vlorë	29,3	12,3	11,9	18,8	1,8	3,9	8,1	4,7	8,0	1,2	100,0


\*2019 Të dhëna gjysmë-finale

Fig.3 PBB për frymë sipas Qarqeve



NUTS 2  
 Qark


PBB për frymë në mijë Lekë



\* Shqipëria ndahet në 3 rajone statistikore niveli 2 dhe 12 rajone statistikore niveli 3, që i korrespondojnë qarqeve ekzistuese, sipas Vendimit të KM nr.1037 datë 15.12.2010, "Mbi Implementimin e Nomenklaturës NUTS" duke ndjekur nomenklaturën mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian"


Shënim: Kufijtë administrativë janë krijuar për qëllime statistikore dhe mund të mos përputhen plotësisht me territorin e njësisë lokale.

Fig. 4 PBB me çmime korente sipas Qarqeve



□ NUTS 2  
□ Qark

PBB në miliardë Lekë



\* Shqipëria ndahet në 3 rajone statistikore niveli 2 dhe 12 rajone statistikore niveli 3, që i korrespondojnë qarqeve ekzistuese, sipas Vendimit të KM nr.1037 date 15.12.2010, "Mbi Implementimin e Nomenklaturës NUTS" duke ndjekur nomenklaturën mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian"

Shënim: Kufijtë administrativë janë krijuar për qëllime statistikore dhe mund të mos përputhen plotësisht me territorin e njësive lokale.



# Metodologjia

Ky publikim paraqet rezultatet e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) për vitin 2019 në Republikën e Shqipërisë sipas rajoneve statistikore në nivel 1, 2 dhe 3, të përcaktuara sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian, si dhe degëve të ekonomisë sipas nomenklaturës NVE Rev 2.

Llogaritë Kombëtare Rajonale bazohen në metodologjinë ESA 2010, kryesisht te Kapitulli 13, duke marrë si bazë vlerësimet më të fundit të Llogarive Kombëtare Vjetore të publikuara më 30 Prill 2021, në mënyrë që të ruhet konsistenca e këtyre treguesve.

Informacioni më i detajuar rreth Llogarive Kombëtare Rajonale (2014-2019) mbi treguesit rajonalë mund ta gjeni në linkun më poshtë.

<http://instat.gov.al/al/temat/ekonomi-dhe-financ%C3%AB/llogarit%C3%AB-rajonale-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/#tab2>

## Metodologji dhe klasifikime

Llogaritjet e treguesve rajonalë mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008). Të dyja këto metodologji janë përditësimet më të fundit të ESA 1995 dhe SNA 1993. Sistemi evropian i llogarive kombëtare dhe rajonale është korniza për matjen e aktiviteteve ekonomike dhe financiare të një sistemi ekonomik, komponentëve të tij dhe lidhjeve midis tyre në një periudhë kohe të dhënë (zakonisht një vit). Transaksionet e kryera nga agjentët ekonomikë në lidhjet e tyre me njësitë e tjera rezidente ose jo rezidente në territorin ekonomik janë objekt i matjeve në llogaritë kombëtare rajonale. Përditësimet e klasifikimeve bëhen që treguesit ekonomikë rajonalë të jenë më të dobishëm për përdoruesit, në mënyrë që të pasqyrojnë zhvillimet ekonomike dhe të përmirësojnë krahasueshmërinë e të dhënave midis rajoneve dhe vendeve anëtare të BE-së bazuar në Nomenklaturën e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian.

## Parimi i Rezidencës

Parimi kryesor për alokimin e VSHB-së në Llogaritë Rajonale është se Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) duhet të alokohet në rajonin ku njësia prodhuese është rezidente, pra që do të thotë se VSHB shpërndahet në rajonin ku krijohet.

Ndryshimet në vlerësimet e Llogarive Kombëtare Vjetore kanë reflektuar dhe në Llogaritë Rajonale si në të dhëna dhe në metodologji. INSTAT ka bërë një ndryshim cilësor në zhvillimin e metodave në vlerësimin e VSHB-së rajonale për ndarjen e veprimtarive ekonomike të ndërmarrjeve dhe institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë kryesore në një apo më shumë rajone.

Në lidhje me metodologjinë e përdorur konsultohuni me materialin: “Metodologjia e Llogarive Rajonale në Shqipëri” në adresën e mëposhtme:

<http://www.instat.gov.al/media/4638/part-e-regional-accounts-albania.pdf>

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare Rajonale janë:

- Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike REV.2 (NVE Rev.2).
- Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS).

**Nomenklatura e njësive territoriale për statistikat (NUTS)** është një klasifikim i përbashkët, në bazë të të cilit mbliidhen dhe përpunohen, statistikat rajonale evropiane.

**Standarti i Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standard-PPS)** është një njësi monedhe artificiale që merr parasysh ndryshimet në nivelet kombëtare të çmimeve. Kjo njësi lejon krahasime të mirëfillta të vëllimit të treguesve ekonomikë për vendet. Agregatet e shprehura në PPS dalin duke pjesëtuar agregatet (treguesit) vlerësuar me çmimet aktuale dhe me monedhën kombëtare përkatësisht me Paritetin e Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Parity-PPP). Indeksi i volumit i PBB-së për frymë i shprehur në Standartin e Fuqisë Blerëse (PPS - Purchasing Power Standards) është dhënë në raport me mesataren e Bashkimit Evropian (BE28=100).

Ju lutem vini re se indeksi i shprehur në PPS përdoret për krahasime midis vendeve sesa për krahasime në termat e serive kohore. Për informacione të mëtejshme mbi koeficientët e PPS ndiqni adresën e mëposhtme:

[https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/prc\\_ppp\\_ind/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/prc_ppp_ind/default/table?lang=en).